



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 70

Datë: 23. 10. 2021. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

Raport nga QNR-ja.

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për Caktimin e Fushatës Zgjedhore për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave

- Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për distinktivë të vëzhguesve të subjekteve politike dhe entiteteve për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të 17 tetorit 2021

4. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për përfaqësimin në KVV për subjektet politike që garojnë për zgjedhjet lokale 2021, raundi i dytë për Kryetar të Komunave.

5. Të ndryshme !

1. Hyrje z. Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi: E hapim mbledhjen e 70-të të KQZ-së sipas rendit të ditës që keni para vetes! A ka dikush diçka me shtuar në rendin e ditës ? Urdhëro z. Rama ?

Alim Rama: Nga Këshilli për Personel ka mbajtur mbledhje, dje dhe kemi ardhur me një rekomandim, por nuk po e di pse nuk është rekomandimi gati. Veç, kjo ish dashur të jetë mbledhja e mbyllur, trajton çështje të personelit...

Burim Ahmetaj: Është mbajtur mbledhja për personelin por, është një lëshim teknik që nuk është përfshirë në agjendë. Nuk jemi të gatshëm, më mirë është ta lëmë për mbledhjen e radhës...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, lidhur me rendin e ditës të propozuar tani, kush është për këtë rend të ditës pa pikën e personelit?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së

Raport nga QNR-ja:

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtarë të KQZ-së, në kuadër të aktiviteteve të sekretariatit kemi një njoftim të shkurtë lidhur me votat me postë dhe raport nga QNR. Sa i përket votave me postë raportin e keni pasur para dy dite në imellë dhe shifër total pas vlerësimit të pakove të supozuara proces i cili ka filluar

me 17 tetor dhe është përfunduar para 3 ditësh rezulton se janë 10.934 zarfe me fletëvotime të ardhura përmes postës ku numri i pakove të aprovuara është 9610 ndërsa numri i pakove të refuzuara është 1324 , ju informoj se pranimi i votave me postë është bërë në QNR me datën 21 tetor dhe në ditët në vijim do të filloj procesi i numërimit të votave me postë. Sa i përket procesit në futjen e të dhënave raporti është i datës 22 tetor dhe pothuajse të gjitha aktivitetet sa i përket futjes së të dhënave janë në masën më shumë se 97% që nënkupton që jemi shumë afër të procedimit të të dhënave si për formularë të rezultateve për kryetar komune po ashtu edhe për kuvendin komunal.

Ajo çka vlen të ceket është se kemi numër shumë të vogël të vendvotimeve apo të formularëve të rezultateve të cilat janë në auditim mirëpo pavarësisht kësaj do ta përgatitim raportin e auditimit në të gjitha to vendvotime që numri është pothuajse shumë i vogël apo shumë simbolik.

Sot, do të fillojë po ashtu edhe procesi i verifikimit apo krahasimit të rezultateve të shënuara në formularë të rezultateve të kandidatëve përkundrejt rezultateve të shënuara në fletët llogaritëse të kandidatëve pra ky hetim do të bëhet në masën 10 % dhe nga barazimet totale rezulton se janë 255 vendvotime të cilat do të hetohen dhe do të krahasohen me të dhënat që janë shënuar në vendvotim me qëllim së të shohim se sa kanë qenë të sakta rezultatet që kanë qenë në formularë të rezultateve dhe varësisht nga të gjeturat do ta paraqesin edhe raportin para KQZ-së ndërsa sa i përket kërkesës apo vendimit të KQZ-së për rinumërimin e vendvotimit në komunën e Fushë Kosovës sekretariati i KQZ-së fillimisht ka bërë hetim paraprak pastaj ka bërë rinumërimin e këtij vendvotimi që është i komunës së Fushë Kosovës pra sipas vendimit të KQZ-së për hetim dhe rinumërim ekipi i hetimit në QNR ka analizuar fletëvotimet në vendvotimin 0906e/01d së pari ka analizuar pra ka shikuar vlefshmërinë e tyre dhe që është kontrolluar se këto fletëvotime a janë të vlefshme, a i takojnë atij vendvotimi sepse secili vendvotim përmban të shtypur të printuar numrin e vendvotimit që i takon dhe të njëjtat nuk mund të përdoren në vendvotime tjera dhe numrat serikë a janë të atij vendvotimi.

Pra, nga vlerësimi i këtyre kritereve të lartë cekura ekipi i hetimit vërteton se fletëvotimet janë të vullosura , përmbajnë numrin e vendvotimit të printuar pra 0906e/01d në fletëvotim dhe numrat serikë të atyre fletëvotimeve i takojnë të atij vendvotimi pra këto janë tri elemente që vërtetojnë se nuk është cënuar integriteti i fletëvotimeve më pastaj janë krahasuar numri i fletëvotimeve të pranuar në vendvotim me numrin e fletëvotimeve të përdorura, dhe rezulton se janë përdorur 700 fletëvotime: 211 fletëvotime kanë qenë të papërdorura ndërsa 489 fletëvotime të përdorura. Prej fletëvotimeve të përdorura, janë 22 fletëvotime që gjatë ditës janë dëmtuar dhe janë futur në zarfin numër 1, 4 fletëvotime janë me kusht që nënkupton se 4 votues kanë votuar me kusht në këtë vendvotim dhe 463 fletëvotime janë brenda kutisë

së votimit. Pra, janë hedhur 463 vota pra numri i fletëvotimeve të hedhura brenda kutisë së votimit është i njëjtë me numrin e nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve.

Nga barazimi i tyre, rezulton se 22 fletëvotime të dëmtuara gjatë ditës janë marrë nga policia hetuese si prova për hetim ndërsa brenda kutisë së votimit janë hedhur 463 fletëvotime prej tyre 5 fletëvotime kanë qenë të zbrazëta ,11 fletëvotime të pavlefshme dhe 447 fletëvotime të vlefshme që gjithsej janë 463 fletëvotime të hedhura brenda kutisë së votimit që është i njëjtë me numrin e nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve.

Fletëvotimet e dëmtuara gjatë ditës sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim nuk përzihen në asnjë mënyrë me fletëvotimet brenda në kuti të votimit , ekipi hetues përpos hetimit ka pasur për detyrë të bëjë edhe rinumërimin e këtyre fletëvotimeve që janë gjendur brenda kutisë së votimit dhe nga rinumërimi rezulton se konfirmohet, pra se janë 5 fletëvotime të zbrazëta, 11 fletëvotime të pavlefshme dhe 447 fletëvotime të vlefshme pra nga rinumërimi është gjendur se në këtë vendvotim një fletëvotim që i takon subjektit me numër 160 është numëruar si votë për subjektin 144 bashkangjitur i keni edhe formularët e rezultateve të krijuara në vendvotim dhe atë të rinumëruar në QNR dhe si rezultat i gjithë kësaj në vendvotimin 0906e/01d që është hetuar dhe rinumëruar me vendim të KQZ-së dhe pas rinumërimin rezulton se të dhënat sa i përket barazimit të fletëvotimeve në FPR për kryetar komune, tejkalojnë nivelin e tolerancës për 22 fletëvotime dhe i njëjti sipas procedurave nuk mund të procedohet më tutje nga QNR.

Për shkak të tejkalimit të nivelit të tolerancës plus minus 3 sipas procedurave dhe raportit nga hetimi rezulton se fletëvotimet e dëmtuara gjatë ditës të cilat janë të vendosura në zarfin numër 1 nuk kanë cenuar votat e hedhura brenda kutisë së votimit dhe rekomandohet KQZ që për vendvotimin 0906e/01d për kryetar komune të rritet niveli i tolerancës në 22 dhe rezultatet e këtij vendvotimi të përfshihen në rezultate përfundimtare.

Kjo, është sa i përket raportit të hetimit bashkangjitur e keni edhe raportin nga ekipi hetues po ashtu i keni formularët e rezultateve të krijuara në vendvotim dhe formularët e rezultateve të rinumëruar nga QNR. E keni raportin nga KKZ në komunën e Fushë Kosovës si dhe raportin e materialeve të cilat janë marrë nga policia e Kosovës...

Kreshnik Radoniqi : A ka dikush diçka lidhur me raportin e sekretariatit ?

Alim Rama: Së pari, mua nuk po më kujtohet që ne kemi kërkuar rinumërimin. Në mbledhjen e fundit, ne kemi kërkuar hetimin e mëtutjeshëm dhe raportin e policisë ndërsa, unë këtu po shoh një shmangie nga

vendimet e KQZ-së nga ana e sekretariatit i cili, ka proceduar me rinumërim. Në mbledhjen e fundit, mbledhja ka qenë e incizuar, dhe kërkesa ka qenë që ai vendotim të mos procedohet deri sa të marrim një raport, shumica prej neve e ka kuptuar për atë problem atë ditë dhe tash unë këtu e pash po ashtu, edhe raportin e progresit nga QNR dhe aty del që të gjitha FPR-të në këtë vendotim në Fushë Kosovë në përgjithësi, janë proceduar d.m.th., para së gjithash pa një vendim të KQZ-së QNR ka vazhduar me procedimin e të gjitha 100% të FRK dhe FPR...

Tash, kjo zgjon edhe një dyshim më të madh pse këto kanë vazhduar të procedohen pa një vendim! Ne, duke pasur një raport të policisë duke pasur një hetim QNR ka vazhduar me procesin këtë vendotim, tash pas djeshit, unë u interesova çka ka ndodhur saktësisht...Raportin e policisë, ne e kemi kërkuar po ashtu, raportin e prokurorit nuk e kemi marrë. Në raportin e policisë, nuk ceket koha kur ka ardhur policia, në bisedë me vëzhguesit dhe komisionarët e lëvizjes poshtë që kanë qenë, çka nuk ceket çka kuptova unë në përfundim të procesit d.m.th., para se me u mbyll vendotimi, tash kjo duhet me u konfirmue...

Unë besoj se, pres konfirmimin e policisë edhe hetuesisë.

Anëtari i KKZ-së nga LDK-ja dhe PDK-ja, edhe anëtari i emëruar nga KKZ që është, edhe më keq, kanë filluar me i vulosë disa fletëvotime që kanë mbetur por, unë përsëri pres një hetim të prokurorit ndërkohë, në momentin që e kërkuan të ndalin, ata kanë filluar t'i grisin dhe për atë kemi 22 fletëvotime të dëmtuara...

Unë, tha z. Rama mendoj se këtu ka ndodhur diçka shumë më e madhe se sa që kemi në raportin e sekretariatit, kështu që larg asaj që kjo të procedohet si e rregullt! Tash, ne kemi edhe një kërkesë tjetër prej sekretariatit: ne, të votojmë shmangien nga rregullat e KQZ-së, e rregulla e KQZ-së thotë se në qoftë se ke diferencë më shumë se 3 fletëvotime, atëherë ato nuk procedohen!

Ne, nuk kemi pasur kërkesë por, tash unë problemi më të madh e shoh pse u hap kjo kuti pa raportin, pa vendim të KQZ-së. Ju mundeni dikush tjetër, por unë si e kuptova mbledhjen e fundit, ne kemi kërkuar hetim dhe nuk kemi votuar fare për këtë, këtu kemi shkelje pas shkeljeje! Shkeljet, kanë filluar në vendotim, kanë vazhduar edhe në QNR dhe mendoj se për mua, ky vendotim është aq i dëmtuar sa që nuk meriton...

Burim Ahmetaj : Vendimi i KQZ-së ka qenë për rinumërim, kështu që në bazë të këtij votimi ne kemi vepruar...

Florian Dushi: E para, është shumë me rëndësi me ditë që hetimi përfshin edhe rinumërimin sepse, hetimi se nuk mundet me ardhë te asnjë konkludim i saktë i çfarëdo hetimi që zhvillohet në raport me një

vendvotim nëse, nuk do të kemi rinumërim edhe të votave për subjekte edhe të votave të pavlefshme edhe të fletëvotimeve të mbetura dhe gjithçka tjetër prandaj, kjo është esenciale për secilin hetim që bëhet. Ju, pa të drejtë në kundërshtim me rregullat me fuqinë e votës, e keni dërguar në hetim një vendvotim i cili, sipas rregullativës tonë të brendshme i ka plotësuar të gjitha kriteret për me u proceduar si i rregullt. Ne, nuk jemi këtu në asnjë rast me i bë hesapet politike dhe mandej me vendos me fuqinë e votës nëse, dojmë me e procedua diçka të rregullt ose jo: 5 rekomandime të QNR-së i kemi votuar në mënyrë unanime pa e kontestua dhe pa e vu në pikëpyetje asnjërin prej tyre por, thjeshtë duke i falë besimin njerëzve të cilët e dinë dhe e njohin dhe e kanë punuar këtë punë.

Në anën tjetër, duke bërë kalkulime të votave të kandidatëve në një komunë të caktuar, provojnë me e dramatizuar një proces i cili, del për të dytën herë po e them prapë, edhe pas një hetimi të padrejtë, të pabazuar por me fuqinë e votës këtu del se i plotëson të gjitha kriteret niveli i tolerancës.

Nëse s'kemi qenë në KQZ, televizionet i kemi pasur në shtëpi dhe keni aprovua nivele të tolerancës në këtë institucion me plus 450, veç me lanë subjekte politike shqiptare jashtë kuvendit të Kosovës, plus minus 450 keni aprovuar nivele të tolerancës dhe e keni ngritur dorën ju këtu që po thoni plus minus 3, po i përmendni prandaj unë kërkoj nga ky institucion shmangien prej hesapeve politike dhe me veprua konform rregullativës tonë të brendshme, dhe konform të gjeturave që janë në atë vendvotim. Keni kërkuar hetim, është zhvilluar hetimi me insistimin e juaj është zhvilluar hetimi pa mbështetjen time dhe, jo pse unë jam frikësuar prej një vendimi të tillë por që e kam vlerësuar që është i panevojshëm në raport me rregullativën tonë.

Ne, nuk mund të ndryshojmë dhe të vendosim rregulla varësisht prej hesapeve të votave të kandidatëve që eventualisht përfaqësojnë këtë institucion prandaj, është kërkuar hetimi, është zhvilluar hetimi dhe në finale ka dalur që është një votë prej një kandidati është gjetur te një kandidat tjetër. Gjithçka, është e përputhshme me rezultatin dhe fletëvotimet e dëmtuara në asnjë rast nuk e kanë as statusin e fletëvotimeve të pavlefshme...

Sami Kurteshi: Këtu po përzihen gjërat edhe me qellim, këtu ka pasur përpjekje për vjedhje industriale, po dhe atë LDK-ja dhe PDK-ja.....

Kreshnik Radoniqi: Ju kisha lutur pak respekt për njëri tjetrin: e përfundon njëri, e vazhdon tjetri dhe ju kisha lutur mos bëni akuza politike...!

Sami Kurteshi: Nëse e kemi një marrëveshje mos me ndërhy, mos ndërhyj: në një vendvotim në komunën e Fushë Kosovës të quajtur "Harilaq" komisionari i PDK-së dhe i LDK-së kanë filluar me i vulosë fletëvotimet

e papërdorura, dhe nga to çenkan 22 që i kanë marrë policia d.m.th., me vjedhë dhe me i vulos pa qenë njerëzit dhe kur u është tërheq vërejtja, i kanë grisur dhe ka ardhur e i ka marrë policia: Po flasim për diçka që është vepër e rëndë penale, dhe thotë jo këtu i kemi votat ka kaluar për një votë, s'kemi votue kurgjo... kemi përpjekje për vjedhje ashtu siç ka ngjarë deri më tash, por s'ka me n'gja ma kjo. Ne, nuk kemi me e lejuar askund një gjë të tillë, as si kemi pasur në Han të Elezit, as si në Skenderaj as askund hiç. Këtu, i kemi votuar 5 rekomandime...e kemi parë që janë në rregull dhe i kemi votuar! E kemi një vendvotim ku ka pasur përpjekje të hapur për vjedhje, ka shkuar policia ka arrestuar njerëz e ne, po e mohojmë jo s'ka ngjarë asgjë se, aty janë disa vota më shumë a më pak...!

Policia ka marrë njerëz, ka burgosur, ka arrestuar njerëz për shkak të shkeljes së kodit të zgjedhjeve që janë vepra penale, krim dhe kjo dënohen me disa vjet burg, dhe ne themi jo nuk është asgjë: shiko, ka thënë QNR-ja...! Jo, as QNR, as sekretariati nuk ka të drejtë me i tejkalue këto...

Arianit Elshani: Këtu, sigurisht ka një tendencë gjithmonë me iu referua të kaluarës se për të ardhmen po shihet se prapë procesi zgjedhor nuk ec siç është më së mbari, e kjo ndoshta duke u varur prej vullnetit të gjithë anëtarëve këtu të KQZ-së. Akuza politike në raport me komisionarë të atij subjekti, komisionarë i këtij subjekti nuk kemi nevojë me i bërë se, e para, unë si anëtar dhe përfaqësues i PDK-së në KQZ bashkë me kolegun Ilir Gashi në mbledhjen e kaluar, kemi kërkuar që ky vendvotim të shkojë në hetim, pra të hetohet nga QNR-ja. Të shikohet qartë se sa fletëvotime janë në fund të fundit për te drejtën edhe për vullnetin e qytetarëve, nuk njohim se kush është komisioner, i kujt është, pra nuk dëshirojmë që asnjë votë të preket ,asnjë fletëvotim që është brenda atyre kutive të votimit të mos preket dhe për këtë arsye kam kërkuar hetim!

Kam insistuar mbledhjen e kaluar që të ketë hetim dhe sot e kemi një raport të zyrtarit të KKZ-së, e kemi një libër të votimit të vendvotimit, brenda, pra që dëshmon procesin dhe procedurat nëpër të cilat ka kaluar ai vendvotim dhe duke iu referuar kësaj, e përmendi z. Dushi më herët se këtu është votuar një tolerancë prej 200 votave, 200 vota kanë munguar në një kuti votimi dhe është votuar po nga anëtarët e KQZ-së, është votuar që të rritet ajo tolerancë brenda KQZ-së me të vetmen arsye që të mbetet një subjekt politik jashtë parlamentit..., një subjekt politik shqiptar jashtë parlamentit, se as nuk u deklarua që jemi pro as kundër këtij rekomandimi...Dëshirojmë që ta analizojmë pikë për pikë librin e votimit, të kemi një raport të policisë se çfarë ka ndodhur me atë vendvotim, pra të kemi një deklaratë të qartë se çka dhe kur janë dëmtuar ato fletëvotime...

KQZ-ja, e ka një përvojë të saj, sekretariati e ka një përvojë prej 2007- es në organizim të zgjedhjeve, dhe këtë përvojë të tyre, duhet ta njohim duhet dhe t'i dimë rrethanat nëpër të cilat ka kaluar në të kaluarën dhe jo të mendojmë se gjithçka fillon pra, nga sot! Ne, kemi pasur probleme edhe me 14 shkurt, është fakt që i kemi pasur ato probleme por i kemi zgjidhur në bashkëpunim me sekretariatit kështu që, unë vlerësoj ashtu siç i kam vlerësuar ato rekomandime që kanë ardhur në mbledhjen e kaluar për hetimin, për rinumërimin, për karantinimin e gjithë atyre kutive të cilët kanë pasur probleme që të hetohen pra të shkohet një proces transparent me ato kamera të vëzhgimit që i kemi vendosur në QNR...

Alim Rama: Tash ti kthehem punës teknike dhe faktike se z. Dushi ja nisi...Thash, unë e kam problemin procedural me këtë vendvotim; këtu shkelja ka filluar me rekomandimin e parë përveç që ka filluar atje çfarë ka ngjarë në vendvotim, neve na rekomandohet ditën e parë që kjo të procedohet si e rregullt...Unë, po e shoh FRP e parë tash pa asnjë nënshkrim të komisionarëve, dhe kjo automatikisht është dashur të shkojë në hetim; Tash kemi një raport të policisë me një faqe: veç konstatimin se kanë marrë 22 fletëvotime pa të dhënat e sakta, kështu që gjithmonë është një tendencë me na përlye të gjithëve, unë pa i ditur detalet kam kërkuar që ky vendvotimi për shkak të mungesës së raporteve të mos procedohet më tutje deri sa kemi pranuar të gjitha materialet por, ne kurrë s'ia kemi dhënë të drejtën QNR-së ose askujt me e hapë këtë vendvotim pa i pritur raportet e institucioneve tjera që i kanë marrë këto.

Ne, kemi qenë atë ditë të njoftuar vetëm edhe vetëm që këtu mungon një zarf me disa vota, disa fletëvotime mungojnë dhe neve na u rekomandu që të procedohet më tutje...

Sami Kurteshi: Këtu, kemi përpjekje për ikje dhe për fshehje. Kur flasim ne të Vetëvendosjes me emra edhe fakte, thonë, shikoni këtu e kanë ngritur dorën për 200 vota e për 400 vota veç, tregoni faktet konkrete me emër dhe me mbiemër, por hiç s'kemi problem me diskutuar për asnjë çështje...Ne, po themi që ky komisionar i kësaj partie dhe i kësaj partie me një anëtar të KKZ-së, kanë vjedhur vota edhe po i përmendi konkretisht se s'kemi arsye çka të fshehim këtu. Nëse doni me e hap çështjen e Listës Serbe urdhëroni, hapeni nëse doni me diskutua çështjen e hapjes së partive me 10 vota, me 12 vota, çështja e 3600 votave të helmuara që i ka nxjerrë ky komision si të helmuara që dy vite e gjysmë, janë në hetime veç që s'kemi qenë as ne as ju, pse po e përmend atëherë? Trego konkretisht, thuaj e ke ngritur t'i dorën; Qe dy vite e gjysmë prokuroria e Republikës së Kosovës që ka krimin e organizuar shtetëror brenda vetes, nuk tregon ku janë hetimet për votat e helmuara serbe këtu që kanë ardhur, çka po mendoni se e bënë atë rastësisht?

Nuk e bën rastësisht, këtu e kemi krimin e organizuar shtetëror dhe këtu është në pyetje fakti se policia ka burgosur tre vetë për veprën penale të shkeljes të kodit zgjedhor se, kanë kshyr me vjedhë vota...A mundeni me fol me këtë gjuhë ndonjëherë apo, vetëm me e fsheh: i kemi numërua, si kemi numërua etj. Ose kemi me fol direkt në këtë institucion sepse, ka qenë paradigma qe 10 vjet sepse, e di unë kush e ka udhëhequr këtë shtet: paradigma ju votoni atje si të doni, vendimin kush ka me fituar, si ka me votuar në këtë tavolinë kjo ka qenë paradigma...Kjo paradigme, është thyer: s'ka me u vendosë në këtë tavolinë kush fiton, ka me u vendosë në vendin e ngjarjes; vota e shenjtë e popullit këtu e kemi për detyrë ne me e numërua sipas ligjit...

Burim Ahmetaj: Kësi akuza nuk toleroj...! Kryesues, nëse mundem sepse, po akuzohemi direkt, të lutem mos akuzo, kryetar të lutem ndërhyj...

Kreshnik Radoniqi: Pesë minuta pauzë, pastaj vazhdojmë....

Florian Dushi: E para, konsideroj që zhurma asnjëherë nuk e zëvendëson argumentin. Ne, bëjmë zhurmë kot këtu, ndërtojmë tregime të rrejshme kot: varësisht nga nevojat që mund ti kemi; I vërsulemi kot sekretariatit dhe njëri tjetrit por, këto janë një hiç përballë argumenteve që i kemi përpara, argumentet që i kemi përpara thonë se mbi 450 qytetarë kanë dalur dhe kanë votuar në mënyrë të rregullt, mbi 460 vota janë të rregullta në kutinë e votimit dhe mënyra si ata kanë votuar është e drejtë e garantuar në këtë shtet me kushtetutë dhe që nuk mundet askush me i zhvlerësuar, prandaj ne merremi me akuza e shpifje këtu kot, edhe për kryetarin e komunës atje, edhe për policinë e Kosovës, edhe për prokurorinë e shtetit etj., se, ashtu na nevojitet në këtë moment...! Por, ka një të vërtetë që është e vetme dhe ajo është që edhe raporti i KKZ-së edhe formulari i plotësuar atë natë nga ekipet të cilat janë zëvendësuar me aprovimin tonë, edhe hetimi që është zhvilluar në QNR ka rezultuar me vetëm një vjedhje të cilën unë s'kisha dashur ndoshta me e përmend dhe, ajo është që kandidatit Burim Berisha një votë i është vjedhur dhe, i është shtuar kandidatit tjetër...

Prandaj, unë kërkoj që përtej se me i bë temë këto ngjarjet politike të dekadës së fundit prej së cilës dikush e sheh veten si shpëtimtar ose e përshkruan veten si shpëtimtar, ne gjërat duhet t'i vlerësojmë dhe ti vendosim konkretisht. Kishim një raport nga QNR i cili thoshte qartë para dy ditëve se, ky vendvotim bazuar në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, bazuar në procedurat e QNR-së të cilat i kemi aprovuar në këtë institucion, i plotëson të gjitha kriteret që të procedohet si i rregullt... E thash edhe më parë: me fuqinë e votës në kundërshtim me rregullat, dhe ne duhet ta kemi të qartë që ky nuk është institucion që

e ka të drejtën me votuar apo me e zbatuar ligjin a jo, por është i thirrur vetëm me e zbatua ligjin në çdo rrethanë...

Ibrahim Selmanaj: Nuk dua ti përsëris ato çka u folën; sigurisht që debati është i mirëseardhur edhe argumentet duhet me u parashtrua nga secili pa u acaruar dhe, jemi duke folur vetëm për një vendvotim dhe procesi i përgjithshëm vlerësohet se ka shkuar mirë edhe si formë edhe si proces për hetim duhet rinumërimi. Nëse rinumërohet vetëm se vijmë te një situatë më e qartë dhe e dijmë se si e kemi situatën, se vota janë të njerëzve tanë, ne po flasim për të drejtën e votës dhe të njëjtën kohë po kërkojmë vetëm sqarim të gjendjes reale çfarë ka ndodhë dhe si e kemi situatën në një vendvotim që bëhet fjalë për Fushë Kosovën; Në këtë rast, unë parimisht e përkrahi pa asnjë kusht administratën.

Më vjen keq se ndoshta nuk janë të mbështetur dhe të përkrahur financiarisht për punën që e bëjnë dhe orarin e tej zgjatur, por tendenca e manipulimit të votave ka me pas edhe ka pas sigurisht që prokuroria edhe hetuesit janë marrë dhe merren prapë, dhe kjo është në vazhdimësi...Konsideroj se duhet të vendoset me votim, dhe të ecim tutje...

Alim Rama: Tash, këtu janë përmendur edhe argumentet por ne realisht, nuk kemi marrë asnjë argument, në fakt, ne nuk kemi pranuar faktin se 22 fletëvotime që janë të dëmtuara në zarfin numër 1 janë marrë nga policia. Pse janë marrë ato ? Pse nuk janë marrë, 10 të tjera ? Pse s'janë marrë ato të papërdorurat, ato fakte nuk i kemi d.m.th., në qoftë se ka tentuar dikush me i marrë fletëvotimet të papërdorura me i vulos edhe me votue me qëllim të prishjes së procesit të votimit, atëherë kjo duhet të zbulohet. Tash, tendenca që me votë në KQZ me kalue një parregullsi, është ndihmesë e asaj parregullësie!

Unë, jam i interesuar që ne ta kryejmë punën ashtu si na garanton kushtetuta që të sigurojmë se secila votë, është e saktë: secili qytetar që ka votuar në Republikën e Kosovës po ashtu, edhe në këtë votimin në Harilaq, tash ne e kemi një raport të KKZ-së të cilin unë nuk po e shoh që e kanë nënshkruar të gjithë.

Edhe raporti unë pres që të jetë i plotë dhe në qoftë se ka pasur opinione të kundërta, nuk bëhen raporte me shumicë. Raportet duhet me qenë të vërteta dhe ti nënshkruajnë të gjithë ata që kanë qenë aty, po unë e ceka ky fletëvotim po thotë që është i procesuar 50 % d.m.th., ne i kemi 50 të procesuara nga 50 vendvotime në Fushë Kosovë. Më mirë është që të merren të gjitha masat, të zbulohet e gjithë e vërteta që ka ndodhur aty, po ndoshta kanë gabuar komisionarët në numërim.

Një votë plus ose minus, nuk është problemi kurrë s'ka qenë problemi këtu një votë plus ose minus. Rregulla e KQZ-së, e përcakton qartë: tolerohet shmangia deri në vetëm 3 vota në qoftë se janë mbi 300, ose 1% në qoftë se janë më pak edhe këtu, iu janë referuar një procesi që as unë nuk kam qenë

anëtar...Tash, e kuptova procesin e vitit 2019 ku sa e kuptova, ndërkohë, aty vendimi është marrë pasi që janë bërë të gjitha verifikimet d.m.th., pasi që kanë marrë raportet janë marrë të gjitha informatat. Këtu, ne s'kemi as raportin e prokurorit, s'kemi as raportin e policisë, kemi vetëm faktin që janë marrë 22 vota; Nuk kemi raport pse janë marrë...

Arianit Elshani: Zgjedhjet, janë mbajtur me 17 tetor. Kanë kaluar 6 ditë pra që nga dita e zgjedhjeve, ndërkohë KQZ dhe sekretariati kanë kërkuar edhe raport të policisë edhe informata me u njoftu lidhur me rastin se çfarë fletëvotime, kur janë marrë ato fletëvotime por këtë të vërtetë nuk kemi një raport të tillë të dijmë saktë se çka ka ndodhur këtu ka hamendësime. Ka ato informata se i ke marrë të njëanshme ndoshta nga zyrtarët tanë në terren mirëpo, nuk e kemi një pasqyrë objektive mbi rastin prandaj, kështu siç kërkuam edhe në mbledhjen e kaluar, kërkoj që të kërkohet rinumërim i plotë i votave të kandidatëve për asamble komunale, të kërkohet rinumërim i votave të kandidatëve për kryetar të komunave dhe njëherit, të kërkohet edhe nga ZKZ-ja një përshkrim i qartë lidhur me vendvotimin.

Ky që e kemi para vetes, nuk i plotëson kriteret për tu vlerësuar si një qëndrim ku na pasqyrohet saktë ngjarjet që kanë ndodhur në vendvotim prandaj kryesues kërkoj nga ju që të insistoni që të kemi një raport sa më shpejtë të detajshëm nga policia e Kosovës , nga prokuroria lidhur me këtë rast sepse ne e kemi caktuar tashmë një datë të raundit të dytë sepse, këtu nuk bëhet fjalë për vjedhje këtu bëhet fjalë se a po hyn Vetëvendosja me LDK-në në balotazh apo, po fiton LDK-ja pa balotazh. Kjo është çështja se, nuk ka këtu këto akuza këto narrativa lidhur me vjedhje ne po shohim që i kemi 400 e disa vota të cilat, mund ti shpallim të pavlefshme pra mund të dërgojmë në rivotim një vendvotim prandaj kërkoj të kemi një pasqyrë të qartë të këtij vendvotimi e pastaj të marrim vendim.

Ky dokumentacion që kemi përpara, nuk është i plotë në tërësi , nuk plotëson të gjitha kriteret të gjitha kushtet për tu votuar nga ana jonë si përfaqësues të PDK-së prandaj kërkojmë një raportim të qartë të këtij vendvotimi .

Kreshnik Radoniqi: Nëse më lejohet, vetëm dy fjalë para se me ja dhënë fjalën z. Kurteshi. Fjala për këto 22 fletëvotime që janë konfiskuar nga policia, do të thotë sipas informacioneve nga prokuroria, janë fletëvotime të cilat nuk kanë arrit, janë plotësuar, i kanë bërë të pavlefshme nuk kanë arritë me i futë në kuti të votimit etj. Prokuroria, nuk mundet me na i dhënë neve tash sepse, është rasti në hetime edhe ata kanë nevojë me i zbatue hetimet në mënyrë të fshehtë si i zbatojnë dhe, nuk munden me na njoftuar krejt me procesin e rastit. Por çka është e konfirmuar nga prokuroria është se, kutia e votimit nuk ka asnjë dyshim që është manipuluar apo është vendosur ndonjë votë e dëmtuar, e pavlefshme, e manipuluar në

atë kuti të votimit...Ka ekzistuar një tentative ta quaj ashtu dhe, nuk është arritur me vepruar më tutje sepse, është ndërprerë, ka intervenuar policia, ka reaguar prokuroria, ka reaguar edhe zyrtari vëzhgues etj.

Komisionari që ka qenë prezent, tha më tej z. Radoniqi, pra kutia e votimit është e pa cenuar, procesi është ndërpre, është vazhduar më komisionar rezervë - jo më komisionarët të cilët kane qen në vendvotim. Fillimisht, edhe është përfunduar numërimi se prokuria e ka lejuar vazhdimin e numërimit dhe përfundimit të procesit. 22 fletëvotime të dëmtuara, janë tërheq si të dyshimta dhe janë në dhomë të dëshmimeve apo ku ta di unë se ku janë; Në hetime pra, është e konfirmuar së kutia e votimit nuk është cenuar: përputhen nënshkrimet e të gjithë votueseve në atë vendvotim, përputhen me numrin e fletëvotimeve që gjenden në kutin e votimit, kjo është më rendësi.

Pra nuk është manipuluar, është tentuar por është ndërpre, ka përfunduar ajo çështje janë marr ato 22 fletëvotime dhe unë konsideroj që procesi nuk është cenuar dhe integriteti është ruajtur nga vet policia, nga vet komisionarët që kanë qenë aty disa prej tyre dhe procesi është në rregull. Sa u përket fletëvotimeve, brenda në kuti përputhet gjithçka me nënshkrime...

Sami Kurteshi: Faleminderit z. Kryesues. Unë mendoj se qetësia e rrejshme dhe rrenat e thëna në mënyrë të qetë, nuk bëjnë të vërteten e këtu, ky shtet është sjell në këtë gjendje pikërisht në këtë mënyrë: me i thanë rrenat në mënyrë të qetë dhe me qetësi të rrejshme duke treguar kjo është ajo që mua më shumë më pengon dhe unë e kam një zakon të keq se kur duhet më fol të vërteten, vërteta duhet të ketë fakte pjese të ndryshme, dëshmi etj. Nuk mund të thuhet vetëm në mënyrë abstraktë! Ne i përmendëm në mënyrë konkrete gjërat, nuk është e vërtetë që kanë gabuar votuesit dhe ato janë fletëvotime të pavlefshme.

Nuk është e vërtetë se përndryshe asnjë votues nuk është burgosur, është e vërtetë që komisionarët në vendvotim bashkë me një anëtar të KKZ-së kanë bërë përpjeke për vjedhje masive të votës duke i vulosur votat; Nuk kane gabuar votuesit, gabon, grisat ajo protokollohet dhe merret fletëvotimi tjetër, pra nuk është ashtu e vërteta është diku tjetër duke e pasur parasysh se kjo është rrugë shumë e rrezikshme dhe unë këtë rrugë të rrezikshme nuk mund të pranojë si të tillë sepse, absolutisht nuk mund ta pranoj vjedhjen e hapur si diçka normale. E dyta, unë nuk qojë dorë për veprime të kundërligjshme për rritje të tolerancës sepse, ne kemi do rregulla sa do të këqija që mund të jenë dhe një ligj e kemi, një rregull e kemi, një ligj sa do që s'pajtohem me to sado që e dimë krejt që ka mangësi.

Megjithatë, nuk mund tash unë të e rris tolerancën për 200, 460 qysh u përmend këtu apo për 22 vota, nuk mund të i ndryshojmë rregullat vetëm qysh na pëlqen, qysh e kërkon momenti ose të themi se ato rregulla nuk janë të vlefshme prandaj, si KQZ-ë ne se kemi autoritetin që në çdo moment normat me i ndryshuar pa marr parasysh a janë të shkruara a s'janë...Këtu ka ngjarë kjo gjatë procedurës, janë ndryshuar normat në këtë institucion, ka ngjare dhe e dimë se cilat janë rezultatet dhe nëse doni, i përmendim me emra por s'ka nevojë se nuk është tema aty...!

Unë, them në një vendvotim në republikën e Kosovës që është fatkeqësisht në Fushë Kosovë, fatkeqësisht në fshatin Harilaq se policia ka arrestuar 3 njerëz që kanë qenë të obliguar sipas ligjit me e përcjell mbar vajtën e votimit ata i ka arrestuar jo për ndonjë krim tjetër vrasje komeditë çka i ka arrestuar për shkak të thyerjes së kodit zgjedhore, për shkak shkëljes së obligimeve të tyre sa i përket zgjedhjeve. Së paku nuk e kemi një informate që ata janë arrestuar për diçka tjetër edhe nuk mund të flitet në mënyre normale për një vendvotim që është trajtuar i tillë d.m.th, ne kemi qindra rekomandime tjera që mundet me pasur lëshime të ndryshme: më pak më – më shumë ka tolerancë, por s'mund të flasim në mënyrë normale në një vend ku ka shkuar policia ka arrestuar njerëz, ka arrestuar njerëz që janë të detyruar me e respektuar ligjin vetëm për zgjedhje për asgjë tjetër...

Kjo për mua, është e kundërligjshme dhe unë nuk e ngriti dorën për veprime të tilla...

Florian Dushi: Tani, edhe ne e kemi versionin tonë të tregimit që na vijnë nga vendvotimi, por unë nuk i shfrytëzoj ato se munden me qenë subjektiv në krejt kohën...Unë jam bazuar në të gjeturat në atë që kam thënë dhe, kam kërkuar vetëm në të gjeturat brenda QNR-së dhe nuk kam përdor tregime të rrejshme të një komisionari të atij vendvotimi sepse, është e lehtë, është i thjeshtë versioni. Tashmë që po merremi me atë pjesë, është që së pari duhet me e kuptuar për çfarë fletëvotimi po flasim! Kur flasim për fletëvotime të dëmtuara, unë nuk thash që qytetaret kanë gabuar por, që munden me gabuar dhe e kthejnë një fletëvotim i cili konsiderohet i dëmtuar dhe e zëvendësojmë me një të ri por tani këtu, u tha se ato 22 vendvotime të cilat janë marr, janë veçuar si pjesa tjetër e fletëvotime të dëmtuara.

Pastaj, u tha se në mbrëmje kanë filluar me i vulosë, epo këtu qëndron rrena sepse ato janë të vulosura, ato kur shkëputen nga fletëvotimet e pa përdorura vulosen dhe i jepet qytetarit, e këtu është tregimi i rrejshëm tani. As policia dhe as prokuroria nuk po thotë se janë marr fletëvotime të pa përdorura dhe janë vulos kjo ka logjike, por këtu po tregohet një tregime i rrejshëm: po thuhet se fletëvotimet e dëmtuara kanë nisur m'u vulosur natën prej komisionarëve për më vjedh vota, e jo se ato kane qenë të vulosura. Fletëvotimet e dëmtuara janë të vulosura, e ka marr qytetari të vulosur, ka gabuar, e ka kthyer

mbrapsht, pastaj tregimi tjetër - mashtrimi tjetër për të cilin kërkoj publikisht që policia të zhvilloje hetime: Kryetari i Fushë Kosovës kanë thënë se në "Selman Rizë" ka mbledhur njerëz...! Unë, kërkoj që policia të zhvilloje hetime, nëse ka mbledhur njerëz le të merr masat e parapara me legjislacionin në fuqi ndaj kryetarit, nëse s'ka mbledhur njerëz le të këqyrë ku është shpifësi, mashtruesi...

Dy akuza ndaj kryetarit të Fushë Kosovës i cili, në ditën e zgjedhjeve as në Fushë Kosovë s'ka qenë, se jo ma në "Selman Rizë", dhe që policia s'ka marr masa prandaj, unë e kuptoj në mungesë të argumenteve duhet më këqyrë të madh e të vogël me bërë fajtor...Por ju lutem: hajde s'i KQZ-ë, ashtu siç na ka hije, mos të merremi me tregime të rrugëve, me tregime që i ndërtojnë për hesape politike por të merremi me një rekomandim profesional...

Alim Rama: Po, është raporti në dhomën operacionale që janë mbledhur njerëzit bazë informatave janë kanë të LDK-së, këtë raport e raportova ditën e zgjedhjeve në dhomën operacionale nga personi përgjegjës i policisë janë ndërmarr masa, është fakt. Polica vendore nuk ka ndërhy deri në moment që ka ardhur urdhër prej dhomës operacionale, ky është fakt. Është një tjetër për kryetarin e komunës në heshtjen zgjedhore në rrugët e komunitetit, kanë përdorur kupon që ka qar qytetaret që janë të varfër që janë bere aktive 15 dite pastaj, më ato nuk po merremi apo, pra kryetari i komunës instrumenton mekanizmin e mirëqenies sociale për më dhen kupona të cilët, përdoren natën e zgjedhjeve çka është kjo në cofte së nuk është instumetalizmi i shtetit, por tani të i kthehem fakteve këtu po thotë që kemi një raport profesional, një raport profesional në qofte së flasim që të gjitha ato fletëvotime që janë brenda siç e murrme këtu nga raporti janë në rregull.

Unë, nuk e pash raportin e analizës nga lista përfundimtare votuese a janë të gjithë ata që kane nënshkruar a janë korrekt, a kemi at raport qysh e dëshmoj unë që 450 votues ose vota përafërsisht sa do që janë, janë votues dikush nuk e ka plotësuar së fillon njëherë më plotësimin e listës votuese pastaj merren fletëvotimet vulosen edhe mbushet kutia ne nuk i kemi të gjitha faktet edhe ne përsëri po tentojmë që më fuqinë e dorës më votën të qesim këtë bërlllok nen tepih. Neve, na vyen të gjitha raportet a është analizuar lista përfundimtare e votuesve a janë të gjitha nënshkrimet atu unike edhe pa keqpërdorime. Neve, na vyen një raport i tërësishëm sa persona kane votuar sakte të cilët kane nënshkrimet unike në listën përfundimtare votuese at raportin nuk e kemi edhe përsëri po tentohet që të kalojmë është absurd ne më vazhduar për këtë teme, kjo duhet mu kthyer në hetime kemi raportin detal policisë, prokurorisë, analizës së listës përfundimtarë të votueseve, unë nuk thash për vendet tjera në Fushë Kosovë, sepse i ka 50 vendvotime.

Unë, e përmenda po ashtu që ka pasur raporte natën e zgjedhjeve, të premtën në mbrëmje, të shtunën që janë bërë aktive kuponat për mirëqenie sociale: aty unë pres hetime. A kanë ndodh hetime këtu që një zyrtar komunal ose kryetar komune të keqpërdor pushtetin me personat që kanë më së shumti nevojë; Ne i kemi të gjitha këto probleme. Në fillim s'janë bërë të mëdha por, gjithë kjo ka shpërthyer në Harilaq sepse aty janë nxënë me letër në dorë, dhe i ka marr policia...

Rifat Krasniqi: Faleminderit kryesues. Unë i dëgjova të gjithë parafolësit çka than, vetëm kryetari që ka fol po më doket definicioni më i mirë! Sa njerëz janë nëpër vendvotime, nëpër komuna dhe, vjen polica i arreston...!? Por, na nuk mundemi për një njeri më i anulue krejt votat, ai vend votimi nuk është në PZAP, ai vendvotime nuk ka ankuar edhe krejt çfarë ka prur krye shefi këtu, po përputhet edhe tani ajo nuk është puna jonë, është puna e policisë, puna e gjykatës, puna e prokurorisë! Puna jonë është që zgjedhjet kanë shkuar mirë...

Arianit Elshani: Kryesues në fjalën tuaj të më pazëshme dhatë disa informata të cilat për të gjithë neve si anëtar janë shumë të rëndësishme që të dimë sakte se ato vota të pavlefshme a janë bere gjate procesit te votimit nga ora 7 mëngjesit deri në ora 19:00 e mbrëmjes, apo ato vota të pavlefshme janë bere pas procesit të votimit, pra pas mbylljes së vendvotimit edhe ju këto informata na dhatë një ore pas mbledhjes së KQZ-së pasi që kishte filluar mbledhja e KQZ-së.

Këtu, shumë gjate u debatua se kur janë dëmtuar si janë dëmtuar, nga kush janë dëmtuar prandaj, konsideroj që të gjitha ato konstatime i dhatë ato informata që na dhatë neve, të njëjtat pra, janë publike, janë në procesverbal dhe unë ju besoj atyre informatave sepse, jeni i thirrur që të ruani integritetin e KQZ-së dhe ne jeni emëruar nga presidentja në këtë pozicion prandaj, kam besim në ato cka i thate ju. Mirëpo, unë abstenoj në votimin për këtë rekomandim. Prandaj konsideroj që edhe kemi konsumuar tashme këtë debat këtë çështje edhe duhet të vazhdojmë në votim...

Burim Ahmetaj : Krejt puna çka e bujmë pasi të pranojmë materialin e ndjeshëm është krejtësisht teknike dhe raportin e pare që është ardhur nga karantina në baze të dokumenteve të cilat janë nënshkruar dhe janë sjell nga anëtarët e këshillit të vendvotimit të cilët kane marr përgjegjësi për të krijuar ato dokumente jemi bazuar në ato dhe jemi të obliguar që të pranojmë ato materiale ashtu si janë pa hy në detaje tash jemi në fazën tjetër ku është kërkuar prej KQZ-së më bo një hetim të hollësishëm për këtë vendvotim dhe nëse e shikojmë librin e votimit askund nuk shkruan që ka pasur votues që kane votuar më shumë së dy here apo, ka pasur ndonjë keqpërdorim. Sa i përket procesit të votimit, janë 463 votues të cilët kanë

hedhur votën në kuti të votimit prej tyre, janë edhe 4 vota me kusht ndërsa, vota të vlefshëm janë gjithsej 447 të cilat sipas fletëvotimeve janë shpërndare nëpër subjekte, varësisht votuesit për cilat kane votuar.

Ndërsa, e kam thane edhe në mbledhjen e kaluar dhe tash, dhe të gjithë e dine se zarfi numër 1 përmban fletëvotime të cilat dëmtohen gjatë ditës dhe të gjitha trupat zgjedhore janë të obliguar së secili fletëvotime që dëmtohet gjate ditës të vendos në at zarf dhe, ai zarfe në asnjë mënyrë nuk përzihet me fletëvotime të rregullta. Në bazë të këtij hetimi, rezulton se nuk është cenuar integriteti i votave të vlefshme ku e kanë hedhur votën 463 votues, pra hetimi është bërë shumë në mënyrë profesionale dhe për këtë arsye, kemi deri 200 vendvotime që s'kemi mundur me i proceduar në rregull për shkak të gabimeve qofte teknike dhe qofte njerëzore apo, çfarëdo problemi tjetër teknik.

Sipas obligimeve dhe sipas vendimit të KQZ-së gjithçka kemi procedua këtë vendvotime proceduralisht mirëpo tani kemi ardhur në një faze për shkak se në at kuti të votimit mungojnë 22 fletëvotime të cilat duhet të shënohen në protokoll në formular të rezultateve më qëllime të barazimit më formën që është nuk mund të procesohet më tutje.

Procedura e lejon deri minus plus 3 nuk e lejon mu proceduar asnjë vendvotim nëse ka mos përputhjen në raport më fletëvotime dhe më nënshkrime më shumë së 3 kështu që rekomandimi është i qarte bazohet në hetimin që është bon që është bo hetime i thellësishem i plote dhe bazohet në faktet që janë brenda kutive së votimit dhe ku askund në raport qofte KKZ-së që kane nënshkruar 5 anëtar të këshillit komunal në komunën e Fushë Kosovës, qofte nga këshillat e vendvotimit që kane nënshkrimin ku vërteton që nuk është bere asnjë shkelje proceduralë gjate procesit ne bazohemi në gjitha ato fakte që kemi.

E kemi kutin e votimit më fletëvotime janë formularët e rezultateve krejt është kjo çka bohet në baze të tyre hetohet dhe rekomandimin e keni par mirëpo e thash edhe më herët më formën që është nuk mund të procedohet më tutje për shkak që 22 fletëvotime janë marr për qëllime të hetimit dhe tash së voni më ka ardhur edhe një konfirmim nga prokuroria rajonale që thotë duke u bazuar në kërkesën tuaj ju njoftojë që 22 vota në vendvotimin në fshatin Harilaq komuna Fushë Kosovë janë marr si mjet i kryerjes së veprës penale për çka ju paraprakisht keni qene të njoftuar për këtë veprim, d.m.th këto 22 fletëvotime në asnjë rast në asnjë moment nuk janë përziej më fletëvotime të vlefshëm dhe kjo na bon të punojmë aq profesional sa bazohemi çka ka kutia çka kane formularët e rezultateve, ju siguroje që gjithçka çka bohet në QNR-ë bohet duke respektuat të gjitha procedurat.

Ibrahim Selmanaj: Faleminderit kryesues, së pari kisha dashtë që para së gjithave të rezervohemi nga cilësimet sepse, nuk i shërbejnë as punës tonë e as vendimmarrjes. Ato këshilla të vendotimeve, unanimisht të gjithë i kemi votuar këtu edhe ata që kane bo përpjeke edhe ata që s'kanë bo përpjeke kështu që, çdo kush që ka bere një parregullsi atëherë jemi të gjithë 11, jemi ata që kemi votuar për secilin komisioner në këshillat e vendvotimit. Nga ajo çka u tha këtu nga QNR-ë, sikur edhe 5 fletëvotime të ishin marr nga dikush dhe të mos dihej ku janë atëherë, kjo do të ndryshonte komplet situatën por ne po e dimë se ku ndodhen fletëvotimet e marra për hetim nga prokuroria dhe, duke marr për baze se ato fletëvotime janë marr për hetim, të njëjta përputhen me të gjitha fletëvotimet e përdorura dhe të pa përdorura, duke përfshirë edhe librin e nënshkrimeve.

Atëherë, kjo ndryshon situatën më pozitive për faktin se dihet se si ka rrjedh i gjithë procesi. Unë dua dhe i besoj vlerësimit që është bere në QNR-ë se kjo kuti, brenda saj përputhet gjithçka, çdo material i cili është i përdorur gjatë ditës së zgjedhjeve prandaj, pavarësisht se kërkohet këtu që të kemi një votim për të rritur tolerancën jashtë rregullave që i kemi. Toleranca nuk rritet për fletëvotime të cilat nuk ekzistojnë por rritet për fletëvotime të cilat e dimë që ndodhen në prokurori. Votimi jonë këtu, nuk e determinon në asnjë mënyrë rezultatin për faktin së në qofte se aty ka pasur manipulime mbi bazën e të gjeturave nga prokuroria, një gjykatë do ta merr një vendim për ta përfshirë ose mos përfshire atë vendvotim në rezultatin përfundimtar. Edhe sikur ne sot të fusim në rezultat përfundimtar, në qofte së aty ka pasur pa rregullsi vendos prokuroria, vendos gjykata ashtu siç e kemi një vendim para dy dite që për dy fjalë përshëndetëse e ka dërguar në rivotime një komunë.

Nëse ka fakte, mund ta qojë edhe komunën e Fushë Kosovës në rivotime por, unë kërkoje që edhe prokuroria edhe gjykata, se e kanë obligim se janë aktere në këtë proces. Prandaj, sa më parë duhet të dalim me një përfundim për këtë vendvotim pastaj, ne kemi edhe disa ditë për të certifikuar rezultatet...Prandaj, si të tillë, unë e mbështes rekomandimin e ardhur nga QNR-ë dhe ju kisha lutur edhe një herë që të kemi një mirëkuptim në raporte tona dhe, mos të lëshohem në cilësime as politike dhe as popullsitë këtu...

Burim Ahmetaj: Në këtë vendvotim, kane votuar 463 votues dhe këto rezultate nuk i ka pru QNR-ë këto rezultate janë ardhur si rezultat i fletëvotimeve të hedhura brenda kutisë së votimit të cilat janë numëruar nga këshilli i vendvotimit më zëvendësimet që janë bo pastaj dhe QNR-ë vetëm e ka konfirmuar baze të hetimeve që brenda kutisë së votimit janë të njëjta rezultate sikur në vendvotime më përjashtim të një votës. Krejt çka kemi bërë, është se kemi hetuar dhe kemi konfirmuar se gjendja është e pa cënueshme

brenda kutsisë së votimit, ndërsa pjesa e fletëvotimeve të dëmtuara gjate ditës nuk është në domenin tonë. Për këtë prokuroria mund të jap sqarime...

Rreth raportit nga QNR, diskutuan më tutje: Alim Rama, Burim Ahmetaj, Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani, Cemajl Kurtesh dhe, Florian Dushi.

Në fund, rekomandimi i QNR-së u hodh në votim.

Për, votuan shtatë (7) anëtarë. Kundër, dy (2) anëtarë: Alim Rama dhe Sami Kurteshi të cilët, nuk morën pjesë në votim. Abstenuan: Arianit Elshani dhe Fazli Stollaj.

Rekomandimi, u kalua nga shtatë anëtarët e KQZ-së.

3.Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për Caktimin e Fushatës Zgjedhore për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave:

Yll Buleshkaj: Para jush, i kemi paraqitur dy rekomandime të cilat de facto, janë para aprovuar me planin operacional por, për shkak të nevojës formale të aprovimit, e kemi paraqitur edhe në forme të rekomandimit në vendim sepse, duhet të merret vendim formal qofte për zgjatjen e fushatës zgjedhore, po ashtu, edhe për distinktivët e vëzhgueseve të subjekteve politike! Pika e parë, është rekomandimi për fushatën zgjedhore. Ashtu siç është bazuar në ligj, në ligjin e zgjedhjeve të përgjithshme po ashtu edhe në rregullën e 10 –të për rundin e dyte për zgjedhjet për kryetare komune, KQZ duhet të vendos për kohëzgjatjen e fushatës zgjedhore për rundin e dyte të zgjedhjeve. Kemi arritur një forme konsensusi edhe gjate hartimit dhe aprovimit të planit operacional që fushata zgjedhore për rundin e dyte të jetë pesë ditë: nga data 8 nëntor, deri më datën 12 nëntor kështu që kërkojmë nga ju që të aprovohet formalisht ky rekomandim...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit, a ka dikush diçka lidhur më këtë pike? Atëherë, kush është për caktimin e fushatës zgjedhore për 5 dite. Kush është për aprovimin e këtij rekomandimi ?

Me vota unanime aprovohet rekomandimi i zyrës për caktimin e fushatës zgjedhore e cila, do të jetë nga data 8 nëntor 2021 duke filluar nga ora 00:00, deri më datën 12 nëntor në ora 24:00.

Alim Rama: Pasi votuam ndaras për fushatën, ne e kemi aprovuar edhe një herë planin operacional i cili i përfshinë këto data, tash një pyetje sekretariatit: A duhet tash ndaras të votojmë edhe për fushatën e

votimit jashtë Kosovës ? Praktika ka qene që ne të kemi datat e rëndësishme ndaras, afati i dorëzimit të pakove fillon më 29 në qofte së me kujtohet prej planit operacional. Janë disa data tjera, kështu që a kemi me votuar ndaras...?

Arianit Elshani: Kryesues, edhe unë kisha kërkuar nga zyra për regjistrimin e partive politike, nga zyra e informimit që të përgatisin ashtu siç kanë përgatitur edhe në të kaluarën, një agjende të aktiviteteve dhe datat e rëndësishme që janë për qytetaret dhe për subjektet politike, për OJQ-të që të kenë njohuri me secilin aktivitetet të KQZ-së për afatet kohore për secilin aktivitet në mënyre që, të jenë të njoftuar ata por edhe ne, pra të mos kemi hamendsime...

Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për distinktivë të vëzhguesve të subjekteve politike dhe entiteteve për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të 17 tetorit 2021:

Yll Buleshkaj: Po, kemi koordinime të mire me zyrën dhe me zëdhënësin dhe, ndërsa subjektet politike i njoftojmë direktet përmes personave të tyre kontaktues që janë të caktuar për këto zgjedhje, ndërsa sa i përket aspektit të vëzhguesve i njoftojmë disa përfaqësues që merren më vëzhguesit e secilit subjekt politike. Sa i përket afateve tjera të cilat mund të ketë nevojë për vendimmarrjen nuk besoj që ka sepse janë të caktuar edhe më rregull këto afatet tjera. Kemi pranuar rekomandimi nga departamenti për çështje ligjore që duhet të merren një vendim formal për caktimin e formatit. Edhe në piken paraprake në planin operacional, është vendosur që distinktivi i vëzhguesve subjekteve politike OJQ-vë për rundin e dyte të krijohen të ri, ndërsa të vjetërit mos te jene të vlefshëm për shkak të uljes së mundësive të mos keqpërdorimi të ndryshëm apo të ngarkimit tepër të madhe të vendvotimit më vëzhgues. E keni të detajuar rekomandimin...

Arianit Elshani: Ky rekomandim, ka rrjedh nga KOZ-i që gjithë këta distinktivë duke ditur numrin e madhe të atyre që janë akredituar që janë diku 25 mijë, pra në total, tani do të kemi vetëm 21 komuna balotazh në rundin e dyte dhe me qëllimin që të lehtësojmë dhe mos lejojmë subjektet politike që vëzhguesit e një komune të cilët janë akredituar për një komune tjetër, të shkojnë në një komune tjetër dhe kështu të tensionojnë apo të sillen brenda qendrave të votimit apo vendvotimeve...

Florian Dushi: Është thane këtu po megjithatë po insistoje këtu që dukja e atyre distinktivë të jete dukshëm e ndryshme nga rundi i pare sepse ndoshta jo secili mundet zyrtare i trupave zgjedhore që të shkojnë të ja marrin dhe të lexojnë po thjeshte të jete tërësisht e ndryshme nga kjo pjese e rundit të pare.

Kreshnike Radoniqi : Dikush tjetër diçka ?

Yll Buleshkaj: Kemi kontaktuar me kontraktin nëse paraqet ndonjë probleme teknik ose me specifika ndërrimi i ngjyrës sepse, në specifika nuk është pare ngjyra që të vendoset por nuk do kemi ndonjë telashe më ndërrimin e ngjyrës së distinktivit. Pra, do të jete një ngjyre totalisht e ndryshme do ta shohim ngjyrë që të jete sa ma lehte që dallohet kemi vendos në forme të verdhës e cila kish mu vrenjte nga largësia që dihet që këta vëzhgues janë të runderit të dyte dhe, nuk janë të tjerë sepse tjerët kane ngjyra të ndryshme. Për subjektet politike, do të jete një ngjyre tjetër e cila dallohet edhe pa shikuar detajet a është vëzhgues i runderit të dyte të gjithë këtyre që u ri akreditohen do të ju krijohet mundësia që të hyjnë në QNR-ë për të vëzhguar procesin për runderin e dyte, ndërsa ata të cilët vazhdojnë të jene, ata do të kenë qasje të plote në QNR-ë deri sa të kryhet procesi i certifikimit të runderit të pare.

Alim Rama: Sa i përket organizatave ndërkombëtare a kane momentalisht distinktivët më ngjyra ndryshe apo janë të njëjta.

Yll Buleshkaj: Për arsye që ngjyrat janë një spektër të caktuar nuk mund të ndryshojmë edhe për shkak që numri i vëzhgueseve ndërkombëtare është i vogël, kemi rekomanduar që edhe vëzhguesit shtese të kenë ngjyrën e njëjte, afati i vlefshmërisë në distinktiv shënon që është deri në fund të vitit . .

Kreshnik Radoniqi : Nëse s'ka dikush diçka tjetër atëherë e hedh në votim. Kush është për ?

Më vota unanime aprovet rekomandimi për distinktiv.

Vazhdojmë më piken e radhës të këshillave të KQZ-së. Këshilli për Operacione Zgjedhore. Z. Elshani ?

4.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për përfaqësimin në KVV për subjektet politike që garojnë për zgjedhjet lokale 2021, raundi i dytë për Kryetar të Komunave:

Arianit Elshani: Faleminderit kryesues, KOZ ka shqyrtuar rekomandimin për përfaqësim në këshillat e vendvotimit që garojnë për zgjedhjet 2021 për runderin e dytë për kryetare të komunave dhe, ketë pikë e kemi shqyrtuar në dy mbledhje të KOZ-it për shkak të debatit dhe qasjeve që kemi pasur lidhur me ketë vendim. Mirëpo, unanimitisht është votuar më ketë përbërje, më falni kërkojë ndjese se me 4 vota për është aprovuar dhe 1 kundër ky rekomandim. Pra, z. Krasniqi ka qene kundër rekomandimit dhe në ketë

rekomandim duke u bazuar në rregullën zgjedhore për rundin e dyte për zgjedhje për kryetare të komunave dhe për ligjin për zgjedhje të përgjithshme është në përshtatshmëri të plote me këtë rregull dhe ligjin.

Kemi aprovuar dy rekomandime: një rekomandim është për ndarjen e pozitave të KKV-ë në komunat ku nuk ka subjekte politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në kuvend të Kosovës edhe tjetri është për ndarjen e pozitave në komunat ku garojnë subjekte politike pra kandidatë të pavarur dhe që nuk janë të përfaqësuar në kuvendin e Republikës së Kosovës i keni para vetes të dy udhëzuesit kryesuesit ashtu siç i takon edhe më ligjin më zgjedhje të përgjithshme do të ndahet më subjektet politike që janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës ndërsa zyrtari i identifikimit dhe dhënësi i fletëvotimit do të ndahet për ato subjekte që marrin pjesë në rundin e dyte të zgjedhjeve në atë komune.

Kreshnik Radoniqi : faleminderit z. Elshani a ka dikush diçka lidhur me këtë pike? Jo, atëherë e hedh në votim kush është për aprovimin e këtij rekomandimi.

Me nëntë (9) vota për, aprovohet ky rekomandim.

5.Të ndryshme ?